# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-463625**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Pagat e magjistratëve, Rama thërret drejtësinë në Kryeministri: Tryezë më 28 shtator për formulën e re |
| ADRESA | `https://prapaskena.com/2026/09/21/pagat-e-magjistrateve-rama-therret-drejtesine-ne-kryeministri-tryeze-me-28-shtator-per-formulen-e-re/` |
| BURIMI | prapaskena.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 19:02:15 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 21 shtator 2026, 09:10:28 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `add29c75bd20f1ead72568d4ddb1181d94821723b6b1614250b71ef11bf2dfae` |
| TEKSTI | `c9e38733d1cd7cc09fd3764735688c17d166039668ac5d8b5846f58619c7a804` |
| PAMJA | `5dd7fe31259e9fd203358ee0c0cda67173dd8c30c09c9b3e63a275060c7c7158` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `ba70eed36eec38ad470dc3764ed210ea710a508fb3f327e07e832a779aed3e99` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/ba70eed36eec38ad470dc3764ed210ea710a508fb3f327e07e832a779aed3e99`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Pagat e magjistratëve, Rama thërret drejtësinë në Kryeministri: Tryezë më 28 shtator për formulën e re

Politikë

Publikuar: 21/09/2026



Kryeministri Edi Rama ka ftuar institucionet e sistemit të drejtësisë në një tryezë të përbashkët konsultimi për çështjen e pagave të magjistratëve.

Top Channel ka mësuar se ftesa ka shkuar për të gjitha institucionet e drejtësisë, duke u njoftuar se takimi do të zhvillohet më 28 shtator, në orën 12:30, në Kryeministri, dhe sipas ftesës synon të shërbejë si pikënisje e një procesi konsultimi dhe dialogu ndërinstitucional për mënyrën e përcaktimit të pagave në sistemin e drejtësisë.

Në ftesën drejtuar institucioneve theksohet se diskutimi do të fokusohet te parimet, kriteret dhe instrumentet që duhet të udhëheqin politikën e pagave, duke pasur në konsideratë qëndrueshmërinë buxhetore, koherencën ndërinstitucionale dhe proporcionalitetin mes funksioneve dhe përgjegjësive.

“Synimi është diskutimi i përbashkët i parimeve dhe elementeve mbi të cilat mund të ndërtohet një mekanizëm i qëndrueshëm, koherent dhe i parashikueshëm për përcaktimin e pagave në sistemin e drejtësisë, sipas standardeve evropiane”, thuhet në ftesë.

Sipas ftesës, konsultimi nuk do të kufizohet vetëm te niveli aktual i pagave, por synon të përcaktojë një mekanizëm të qëndrueshëm për përcaktimin dhe rishikimin periodik të tyre.

Qeveria kërkon që ky mekanizëm të mbështetet në rregulla të qarta dhe objektive, duke synuar një qasje të përbashkët mes institucioneve.

## Më të lexuarat


Gratë e PD-së që u shtrinë në zyrën Gys Agasit, njëra u shfaq me makinë 70 mijë euro / Fara...


500 mesazhe / “Do përfundojmë keq shpirt”. Si raportonte kryeagjentja Vlora Hyseni te Gys Agasi p...


Besuria e ‘çmendur’ e Benet Becit, si po i pastron paratë e korrupsionit me tendera n...


Të gjithë e dinin në Baku, Vlora Hyseni shfaqet në Kosovë dhe dorëzohet te autoritetet


Çifti Brunilda Isufi dhe Mauro Borghi që helmojnë shqiptarët me djathë me baktere të rrezikshme, ...

Në dokument theksohet gjithashtu se procesi synon të kontribuojë në pavarësinë, integritetin dhe profesionalizmin e sistemit të drejtësisë, ndërsa njëkohësisht të garantojë qëndrueshmërinë financiare të shtetit.

Ftesa e Ramës vjen në një moment kur çështja e pagave të magjistratëve është kthyer në një debat institucional mes organeve të drejtësisë dhe ekzekutivit.

Pak ditë më parë në Kuvend është miratuar gjithashtu një formulë e re për pagën referuese, duke e çuar koeficientin nga 0.36 në 0.38 të pagës së Presidentit, ndërsa kjo formulë është kundërshtuar nga disa institucione të drejtësisë.

TAG: Edi rama

## Të ngjashme



**Xhafaj, kritika kreut të Agjencisë së Eficencës së Energjisë: Institucioni më jo korrekt, ju deshën 5 muaj për të kthyer përgjigje!**




**Nufi: "Shqipëria, e palëkundur në angazhimin e saj drejt forcimit të bashkëpunimit rajonal në mbrojtje e siguri"**



**Balla vizitë me eurodeputetët në Zvërnec: Projekti synon të shërbejë si një shembull se si investimet e mëdha ndërkombëtare mund të realizohen në p...**

## Prapaskena

'Prapaskena' lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuara me interesat klienteliste, krimit dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

## Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

## Kategoritë



Email: [email protected]

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena
Privacy Policy | Cookies

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.